

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.21.05.2023*

**21.05.2023  
Ora 12:37**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:                                      **Z.Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:**                                **PDIU**
- **Të tjerë:**                                        **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita, atëherë në seancën e sotme kemi në rend dite miratimin e rezultatit të votimit për kryetarë të bashkisë dhe të këshillit bashkiak, për Bashkinë e Tiranës dhe për Bashkinë e Durrësit. Atëherë fillojmë me pikën e parë që ka të bëjë me miratimin e tabelave përmbledhëse për votimin për Kryetarë të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të Tiranës.

**Z. Y. Merkaj:** Po faleminderit, zona zgjedhore Bashkia Tiranë, ka në përbërjen e saj tre nga zonat të administrimit zgjedhor dhe përkatësisht KZAZ-në numër 29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40 dhe 41. Pas përfundimit të procesit të

**Zbardhi materialin audio  
Janida Kocaqi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.21.05.2023*

numërimin të votave KZAZ-të përkatëse, kanë plotësuar dhe miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit të cilat i kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sëbashku me vendimi për miratimin e këtyre tabelave si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi, si për Kryetarin ashtu edhe për Këshillin e Bashkisë Tiranë, përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit u kontrolluan tabelat përmbledhëse të KZAZ-ve përkatëse, nëse tabelat e rezultatit të këtyre KZAZ-ve të zonave përkatëse përfshin të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe do të rezultoj se tabelat përmbledhëse të rezultatit të KZAZ-ve, për Kryetar ashtu edhe për Këshillin e Bashkisë Tiranë, përfshin rezultatet e të gjitha qendrave të votimit të çdo qendre votimi të kësaj zone zgjedhore, KQZ-ja do të njoftoj me vendim tabelen përmbledhëse të rezultatit për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Tiranë duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor, për këtë arsye i propozojmë Komisionerit miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit për Kryetarin e Bashkisë Tiranë dhe Këshillin e Bashkisë Tiranë sipas pikës 1 dhe 2 bashkëngjitur këtij vendimi, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, përfaqësues të partive nuk kemi, dakord. Mirë atëherë, miratojmë rezultatin e votimit për Kryetar të Bashkisë Tiranë dhe tabelat përmbledhëse me të dhënat vijuese:


-Fletë votimi të gjetura në kutinë 302 mijë e 695.

-Vota të pavlefshme 11 mijë e 939.

-Fletë votimi të hedhura gabim 339.

-Fletë votimi të vlefshme 290 mijë e 446 të ndara sipas kandidatëve, zoti Arlind Qorri nga Lëvizja Bashkë, 13 mijë e 851 vota të vlefshme, zoti Marko Dajti nga

*Zbardhi materialin audio  
Jonida Kocaqi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.21.05.2023*

Fronti i Majtë 2,809, zonja Lala Përnicka nga Partia Drejtësi Integrim 2,107, nga kandidati fitues për kryetar të Bashkisë Tiranë zoti Erion Veliaj 158 mijë e 856, për zotin Belind Këlliçi kandidat i mbështetur nga Koalicioni Bashkë Fitojmë 100 mijë e 425 dhe nga zoti Roland Bejko kandidat i Partisë Demokratike për Bashkinë e Tiranës 12 mijë e 398 vota.

Miratojmë edhe tabelën përmbledhëse të rezultateve për votim për anëtar të këshillit.

- Fletë votimi të gjetura në kutitë e votimit 302 mijë e 698.
- Vota të pavlefshme 10 mijë e 337.
- Fletë votimi të gjetura gabim të hedhura në kutinë e gabuar janë 343.
- Vota të vlefshme 292 mijë e 52.

Shpërndarja e votave të vlefshme është si vijon:

- Koalicioni Bashkë Fitojmë 68 mijë vota të vlefshme.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 147 mijë e 272.
- Partia Agrare Ambientaliste 3,396.
- Partia Republikane 4,454.
- Partia Lëvizja e Legalitetit 3,529.
- Partia Demokracia Sociale 1,509.
- Aleanca Liberale e Djathtë 694.
- Partia Social Demokrate 12 mijë e 796.
- Partia Demokratike 19 mijë e 827.
- Aleanca Progresiste LZHK 4,760.
- Fryma e Re Demokratike 1,735.
- Partia Drejtësi Integrimi dhe Unitet 5,313.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida Kocaqi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.21.05.2023*

- Aleanca Arbnore Kombëtarë 1,957.
- Partia Balli Kombëtar 555.
- Partia Konservatore 1,723.
- Nisma Thurrje 6,993.
- Lëvizja Bashkë 7,539.

**Vendimi nr. 542**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida Kocaqi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.21.05.2023*

21.05.2023  
Ora 12:43

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Durrës për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:                                              **Z.Y. Merkaj,**
- **Parti Politike:**                                              **S’ka**
- **Të tjerë:**                                                      **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë kalojmë tek Bashkia Durrës.

**Z. Y. Merkaj:** Zona zgjedhore Bashkia Durrës, ka në përbërjen e saj 4 zona të administrimit zgjedhor dhe përkatësisht KZAZ-në numër 21,22,23 dhe 24. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-të përkatëse, kanë plotësuar dhe miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit të cilat i kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sëbashku me vendimi për miratimin e këtyre tabelave si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi, si për Kryetarin ashtu edhe për Këshillin e Bashkisë Durrës, përpara plotësimit të tabelës

*Zbardhi materialin audio  
Jonida Kocaqi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.21.05.2023*

përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore u kontrolluan tabelat përmbledhëse të KZAZ-ve 21,22,23 dhe 24 nëse tabelat e rezultatit të këtyre KZAZ-ve të zonave përkatëse përfshin të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe do të rezultoj se tabelat përmbledhëse të rezultatit të KZAZ-ve, për Kryetar ashtu edhe për Këshillin e Bashkisë, përfshin rezultatin e të gjitha qendrave të votimit të zonës përkatëse përveç rezultatit të qendrës së votimit numër 1467/03 KZAZ-së numër 22 pasi me vendim të kësaj KZAZ-je, fletët e votimit për Këshillin e Bashkisë janë shpallur si kuti e parregullt. KQZ-ja do të miratoj me vendim tabelen përmbledhëse të rezultatit miratuar duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor, për këtë arsye i propozojmë Komisionerit miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit për Kryetarin e Bashkisë Durrës, sipas pikës 1 dhe 2 bashkëngjitur këtij vendimi, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, atëherë miratojmë rezultatin e votimit për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Durrës dhe tabelën përmbledhëse përkatëse me të dhënat vijuese;

- Fletë votimi të gjetura në kuti 89 mijë e 871.

-Vota të pavlefshme 2,478.

-Fletë votimi të hedhura gabim 102.

-Vota të vlefshme 87 mijë e 296 të ndara sipas kandidatëve, zotit Igli Cara për kandidat për Kryetar të Bashkisë Durrës mbështetur nga Koalicioni Bashkë Fitojmë 38 mijë e 784, dhe kandidatja fituese për Kryetare të Bashkisë Durrës mbështetur nga Partia Socialiste zonja Mirjana Sako ka marrë 48 mijë e 512. Tabela përmbledhëse për Këshillin e Bashkisë miratohet me të dhënat vijuese:

*Zbardhi materialin audio  
Jonida Kocaqi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.21.05.2023*

-Fletë votimi të gjetura në kuti 89 mijë 648.

- Vota të pavlefshme 2,773.

-Fletë votimi të hedhura gabim 120.

-Vota të vlefshme 86 mijë e 757.

Shpërndarja e votave të vlefshme është si vijon:

-Koalicioni Bashkë fitojmë 21 mijë 286.

- Partia Socialiste e Shqipërisë 43 mijë e 861.

- Partia Agrare Ambientaliste 5378.

- Partia Republikane 631.

-Partia Lëvizja e Legalitetit 347.

- Partia Demokracia Sociale 404.

- Aleanca Liberale e Djathtë 663.

-Partia Social Demokrate 2,343.

- Partia Demokratike 8,111.

- Aleanca Progresiste LZHK 531.

- Fryma e Re Demokratike 642.

- Partia Drejtësi Integrimi Unitet 1,811.

- Partia Balli Kombëtar 139.

- Ardhmëria Shqipëtare 610 vota.

Mirë këtu përfunduam, seanca mbyllet!

**Vendimi nr. 543**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida Kocaqi*

